



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 992/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhferi dhe Adnan Konushevci, anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Mentor Ismaili, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Lipjan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.992/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Mentor Ismaili nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Lipjan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Mentor Ismaili nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Lipjan, me të cilën kërkon që të bëhet rinumërimi i votave pasi që sipas parashtruesit të apelit i mungojnë votat e për të cilat i njëjti thekson se votuesit e tij dëshmojnë se kanë votuar për të. Parashtruesi i apelit thekson se këto parregullsi kanë ndodhur në këto qendra të votimit dhe në vendvotimet si në vijim: në qendrën e votimit 1325 në vendvotimet 1,2,3 ne Banullë, në qendrën e votimit 1310 në Konjuh, Shalë 1304, vendvotimi 1302, qendra e votimit 1324, qendren e votimit 1329 e vendvotimet 1 dhe 2,

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për manipulime të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thëniet e tij janë vetëm supozime dhe jo të konkretizuara në asnjë provë konkrete bindëse andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Mentor Ismaili nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Lipjan, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.992/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.